



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ
OSNOVNI SUD UROŠEVAC – BASIC COURT OF FERIZAJ

Raporti i rregullt i punës
GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ
Prill– Qershori 2023

RAPORTI I RREGULLT I PUNËS SË GJYKATËS THEMELORE NË FERIZAJ

(Periudha 1 Prill deri me 30 Qershori 2022)

Bazuar në ninin 14 paragrafi 2 pika 2.5 të Ligjit për Gjykatat, Kryetari i Gjykatës Themelore në Ferizaj, paraqet raportin e rregullt të punës për periudhën 1 prill - 30 qershori 2023.

Gjykata Themelore në Ferizaj së bashku me degët e sajë në Kaçanik dhe Shtërpcë në dhjetor të vitit 2022 ka hartuar planin dhe programin e punës për vitin 2023, plan ky i aprovuar në kolegjumin e gjyqtarëve të Gjykatës Themelore dhe degëve të sajë, në kuadër të këtij plani është paraparë trajtimi në mënyrë specifike i efikasitetit të gjykatës në kuptimin e veprimeve të cilat ndërlidhen me zgjidhjen e numrit të lëndëve gjegjësisht çështjeve gjyqësore brenda afateve të arsyeshme ligjore, gjë që konsiderojmë se në tremujorin e parë dhe të dytë, të vitit 2023 ky plan është zbatuar.

Gjykata Themelore në Ferizaj së bashku me degët e sajë në Kaçanik dhe Shtërpcë përmes këtij raporti prezanton në mënyrë përbledhëse punën e gjykatës gjatë tremujorit të dytë të vitit 2023, duke prezantuar njëkohësisht të arriturat dhe sfidat gjatë kësaj periudhe raportuese, si në aspektin profesional ashtu edhe në atë administrativ, me qëllim të paraqitjes së volumit të punës së kryer në formë statistikore dhe tabelore në vazhdim.

Aktualisht Gjykata Themelore në Ferizaj me degët në Kaçanik dhe Shtërpcë ka të angazhuar gjithsejtë njëzet e nëntë (29) gjyqtar duke përfshirë edhe kryetarin e gjykatës. Ndërsa numri total i të punësuarve në Administratën e Gjykatës Themelore në Ferizaj dhe degët e sajë në Kaçanik dhe Shtërpcë është 131 persona përfshirë Administratorin e gjykatës dhe dy ndihmës administrator.

Në aspektin financiar, gjatë periudhës raportuese, ekipi financiar ka qenë i konsoliduar dhe ka arritur ti përfundoj me sukses detyrat që kanë të bëjnë me çështjet financiare. Në këtë periudhë raportuese (prill-qershori 2023), zyra e financave ka realizuar: të hyra gjyqësore të cilat janë

derdhur në Buxhetin e Konsoliduar të Republikës së Kosovës e që kanë qenë 247,167.58 €, prej tyre 178,160.00 € janë të hyra nga gjobat dhe 69,007.58 € pagesa nga taksat dhe paushallët gjyqësore, ndërsa shpenzime buxhetore për nevojat e gjykatës gjatë këtij tremujori kanë qenë 223,700.00 €, prej tyre 52,860.06 € janë shpenzuar për mallra dhe shërbime, ndërsa 10,202.85 € për shpenzime komunale.

Gjykata për periudhën raportuese, në kuadër të Udhëzimit Administrativ (02/2016) për Anonimizimin dhe Publikimin e Aktgjykimeve, ka vazhduar publikimin e aktgjykimeve të anomomizuara dhe për këtë periudhë janë publikuar rreth 510 aktgjykime.

Web Portali i gjyqësorit edhe për këtë periudhë ka shërbyer si urë lidhëse ndërmjet publikut dhe gjykatës kjo me qëllim të informimit të publikut rreth aktiviteteve, orarit të seancave gjyqësore, vendimeve dhe të tjera, ndërsa përmes rrjetit social facebook publikut i është mundësuar qasje më e lehtë në punën e gjykatës. Përveç këtyre shërbimeve të cilat ofrohen në portalin gjyqësor dhe rrjetet sociale, si shërbime shtesë të cilat dëshmojnë transparencën e gjyqësorit karshi publikut, në hyrje të gjykatës janë të vendosur tre monitorë të cilët pasqyrojnë kalendarin me orarin e seancave gjyqësore si dhe tabela orientuese, këto si në Gjykatën Themelore në Ferizaj ashtu edhe në degët e sajë në Kaçanik dhe Shtërpcë.

Gjithashtu Gjykata Themelore Ferizaj e përkrahur nga USAID- Projekti për Drejtësi është duke vazhduar Projektin për Drejtësi Procedurale dhe atë përveç në Gjykatën Themelore në Ferizaj tanë më edhe në degën në Kaçanik dhe Shtërpcë, krejt kjo me qëllimin e përmirësimit të cilësisë dhe qasje në shërbimet të cilat ofrohen nga gjykata.

Gjithashtu dega e gjykatës në Shtërpcë përmes projektit të ofruar dhe mbështetur nga Zyra e UNMIK-ut në Kosovë ka realizuar renovimin e objektit të degës e që ka të bëj me fasdimin e jashtëm dhe të brendshëm si dhe përmirësimin dhe kyqjen në rrjetin e kanalizimit.

Gjykata Themelore në Ferizaj gjatë kësaj periudhe ka vazhduar bashkëpunimin me institucionë, veprimtaria e të cilave mundë të ketë ndikim në aspektin e efikasitetit apo të ngritjes së besueshmërisë së opinionin publik përgjithësi në gjykatë ka vazhduar të shfaqë efekte pozitive si në zbatimin e urdhëresave të lëshuara nga gjykata, ashtu edhe me zbatimin e vendimeve nga ana e institucioneve si nga ana e Policisë së Kosovës, Prokurorisë Themelore Ferizaj. Bashkëpunimi me

Prokurorinë Themelore në Ferizaj është i vazhdueshëm, po aq sa edhe me Policinë Rajonale të Ferizajt.

Statistikat

Gjatë periudhës raportuese gjykata së bashku me degë ka të evidentuara në punë 29389 lëndë (pa përfshirë lëndët kundërvajtëse) në Departamentin për Krime të Rënda, në Departamentin e Përgjithshëm, Divizioni Penal dhe Civil, janë përfunduar 2468 lëndë, ndërsa kanë mbetur të pa përfunduara 26921 lëndë.

Departamenti për Krime të Rënda gjatë periudhës raportuese ka pranuar 25 lëndë, ka përfunduar 64 lëndë, ndërsa kanë mbetur të pa përfunduara 278 lëndë. Norma e spastrimit të lëndëve për këtë periudhë në DKR është 256.00%.

Departamenti për të Mitur në periudhën raportuese ka pranuar 26 lëndë, ka përfunduar 32 lëndë, ndërsa kanë mbetur të pa përfunduara 165 lëndë. Norma e spastrimit të lëndëve për këtë periudhë është 123.08 %.

Në Departamentin e Përgjithshëm-Divizioni Penal (së bashku me degë), pa përfshirë procedurën paraprake në periudhën raportuese ka pranuar gjithsej 313 lëndë, ka përfunduar gjithsej 397 lëndë, ndërsa kanë mbetur të pa përfunduara 3119 lëndë. Norma e spastrimit të lëndëve për këtë periudhë është 126.84 %.

Në Departamentin e Përgjithshëm-Divizioni Civil (së bashku me degë), gjatë këtij tremujori janë pranuar gjithsej 790 lëndë, ka përfunduar 570 lëndë, ndërsa kanë mbetur të pa përfunduara 8827. Norma e spastrimit të lëndëve për këtë periudhë është 72.15 %. Kjo përqindje e ulët e normës së spastrimit është si rezultat i ardhjes së numrit të madhe të kërkesave civile, konkretisht lëndëve që kanë të bëjnë me kontratat kolektive të punonjësve të arsimit, shëndetësisë dhe policisë.

Në Departamentin e Përgjithshëm-Divizioni Kundërvajtës (së bashku me degë) gjatë këtij tremujori ka pranuar gjithsej 713 lëndë, ka përfunduar 683 lëndë, ndërsa kanë mbetur të pa përfunduara 4725 lëndë. Norma e spastrimit të lëndëve për këtë periudhë është 95.79 %.

Gjykata Themelore në Ferizaj me Degë

Në vazhdim tabela 1 përmban të dhënat për lëndët e trashëguara, të pranuara, në punë, të kryera dhe lëndët e pa kryera për tremujorin e dytë të vitit 2023 (1 prill deri më 30 qershor 2023) për Gjykatën Themelore në Ferizaj me degë

Lloji i lëndëve	Lëndët të trashëguara	Lëndë të pranuara-2023	Gjithësejt lëndë në punë	Lëndë të kryera	Gjithësejt lëndë të pa kryera
Procedura Paraprake - DP	597	75	672	53	619
Penale shkalla e parë- DP	3203	313	3516	397	3119
Procedurë Paraprake - DKR	247	36	283	40	243
Penale shkalla e parë - DKR	317	25	342	64	278
Penale për të mitur në proc.përgaditore	36	16	52	6	46
Penale për të mitur në proc.Para Kolegjit	171	26	197	32	165
Civile të shkallës së I-rë	8607	790	9397	570	8827
Jashtëkontestimore	618	78	696	97	599
Trashëgimore	4328	493	4821	373	4448
Përbarime sipas dokumenteve autentike	1914	24	1938	30	1908
Përbarime sipas dokumentit përbuarues	884	47	931	188	743
Ekz.Pausalla dhe shpenzime gjyqësore	4303	356	4659	317	4342
Ekz.civile PPP	391	22	413	33	380
Ekz.Penale me burg	180	58	238	54	184
Ekz. Penale me gjobë- EDGJ	1041	185	1226	212	1014
Ekz.i masave edukative për të mitur	3	5	8	2	6
UGJK	0	0	0	0	0
GJITHËSEJT	26840	2549	29389	2468	26921
Lëndët tjera: certifikata, v.apostile, etj	0	0	0	0	0
<hr/>					
Lëmia Kundërvajtëse	Lëndët të trashëguara	Lëndë të pranuara-2023	Gjithësejt lëndë në punë	Lëndë të kryera	Gjithësejt lëndë të pa kryera
Lëmia- Kundërvajtëse	4695	713	5408	683	4725
GJITHËSEJT	4695	713	5408	683	4725

Në bazë të statistikave si në tabelën më lartë rezulton se Departamenti për Krime të Rënda, shprehur në përqindje ka përfunduar 256.00 % të lëndëve në raport me numrin e lëndëve të pranuara në periudhën raportuese, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Penal, shprehur në përqindje ka përfunduar 126.84 % të lëndëve në raport me numrin e lëndëve të pranuara në periudhën raportuese, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, shprehur në përqindje ka përfunduar 72.15 % të lëndëve në raport me numrin e lëndëve të pranuara në periudhën raportuese.

Ndërsa në total norma e spastrimit të lëndëve të pranuara në raport me lëndët e përfunduara në Gjykatën Themelore në Ferizaj së bashku me degët Kaçanik dhe Shtërpccë (pa përfshirë lëndët kundërvajtëse) është 96.82 %, megjithatë kjo shkallë e efikasitetit duhet të ngritët, andaj gjatë muajve në vijim prioritet i gjykatës do të vazhdoj të jetë përfundimi i sa më shumë lëndëve të vjetra të parapara edhe me strategjinë për reduktimin e lëndëve të vjetra si dhe përfundimi i lëndëve me natyrë korruptive.

Gjykata Themelore në Ferizaj

Për periudhën raportuese nga data 1 prill deri me 30 qershor 2023 në Gjykatën Themelore në Ferizaj , në fillim të kësaj periudhe raportuese kanë të trashëguara nga periudha e tremujorit të parë 20292 lëndë, janë pranuar 2038, ndërsa janë përfunduar 1908 lëndë, që shprehur në përqindje janë 93,62% efikasiteti në gjykatë.

Nga në fillim të kësaj periudhe raportuese kanë të trashëguara nga periudha e tremujorit të parë 3570 lëndë, janë pranuar 539, ndërsa janë përfunduar 428 lëndë, që shprehur në përqindje janë 79.41% efikasiteti në gjykatë.

Në vazhdim tabela përmban të dhënat për lëndët e trashëguara, të pranuara, në punë, të kryera dhe lëndët e pa kryera për tremujorin e dytë të vitit 2023 (1 prill deri më 30 qershor 2023) për Gjykatën Themelore në Ferizaj

Lloji i lëndëve	Lëndët të trashëgura	Lëndë të pranuara-2023	Gjithësejt lëndë në punë	Lëndë të kryera	Gjithësejt lëndë të pa kryera
Procedura Paraprake - DP	446	51	497	33	464
Penale shkalla e parë- DP	2181	235	2416	269	2147
Procedurë Paraprake - DKR	247	36	283	40	243
Penale shkalla e parë - DKR	317	25	342	64	278
Penale për të mitur në proc.përgaditore	36	16	52	6	46
Penale për të mitur në proc.Para Kolegjit	171	26	197	32	165
Civile të shkallës së I-rë	6798	671	7469	412	7057
Jashtëkontestimore	277	64	341	70	271
Përbartimore	3126	360	3486	304	3182
Përbartime sipas dokumenteve autentike	1289	24	1313	30	1283
Përbartime sipas dokumentit përbartues	820	47	867	188	679
Ekz.Pausballa dhe shpenzime gjyqësore	3352	260	3612	218	3394
Ekz.civile PPP	233	14	247	20	227
Ekz.Penale me burg	146	50	196	47	149
Ekz. Penale me gjobë- EDGJ	850	154	1004	173	831
Ekzi masave edukative për të mitur	3	5	8	2	6
UGJK	0	0	0	0	0
GJITHËSEJT	20292	2038	22330	1908	20422
Lëndët tjera: certifikata, v.apostile, etj	0	0	0	0	0
Lëmia Kundërvajtëse	Lëndët të trashëgura	Lëndë të pranuara-2023	Gjithësejt lëndë në punë	Lëndë të kryera	Gjithësejt lëndë të pa kryera
Lëmia- Kundërvajtëse	3570	539	4109	428	3681
GJITHËSEJT	3570	539	4109	428	3681

Gjatë tremujorit të dytë, angazhimi i gjyqtarëve me qëllim të zvogëlimit të numrit të lëndëve dhe zgjedhjes sa më shpejtë të tyre ka reflektuar pozitivisht, megjithatë duhet të theksohet fakti se Gjykata Themelore në Ferizaj vazhdon të ketë mungesë të numrit të gjyqtarëve në departamentin e përgjithshëm sidomos divizioni penal.

Aktualisht në Departamentin për Krime të Rënda janë të angazhuar pesë (5) gjyqtar përfshirë edhe kryetarin e gjykatës, në Departamentin për të Mitur është i angazhuar një (1) gjyqtar, në Departamentin e Përgjithshëm-Divizioni Penal janë të angazhuar 5 (pesë) gjyqtar (njëri prej tyre i cili është trajnim për gjyqtar fillestar në Akademinë e Drejtësisë, është caktuar në këtë divizion dhe do të filloj trajtimin e lëndëve pas përfundimit të trajnimit gjatë muajit korrik, ndërsa një gjyqtar nga gjysma e dytë e muajit qershori gjendet fillimisht në pushim mjekësor, për të vazhduar gjyqtar nga gjysma e dytë e muajit qershori gjendet fillimisht në pushim lehonie), në Departamentin e Përgjithshëm-Divizioni Civil janë të angazhuar shtatë (7) me pushim lehonie), në Departamentin e Përgjithshëm-Divizioni Civil janë të angazhuar shtatë (7)

gjyqtar (dy prej të cilave janë të minoritetit serbë dhe kanë vështirësi në kryerjen e punëve në gjykatë, për shkak të përkthimit, mungesës së zyrtarëve ligor dhe stafit mbështetës serbë. Një gjyqtar i caktuar së fundmi të punoj në këtë divizion është trajnim për gjyqtar fillestare në Akademinë e Drejtësisë, dhe do të filloj trajtimin e lëndëve pas përfundimit të trajnimit gjatë muajit korrik), përfshirë këtu edhe gjyqtarin mbikëqyrës të degës në Shtërpcë i cili trajton vetëm lëndët me të cilat ka qenë i ngarkuar më parë. Njëri nga gjyqtarët e caktuar në divisionin civil është i ngarkuar për trajtimin vetëm të lëndëve përmbarimore.

Sa i përket departamenti të përgjithshëm, divizioni penal nga data 19.06.2023 një gjyqtare e këtij divizioni është në pushim të lehonisë dhe në këtë divizion mbeten caktuar katër (4) gjyqtar.

Ndërsa në Divisionin për Kundërvajtje janë të angazhuar dy (2) gjyqtar.

Në Gjykatën Themelore në Ferizaj- dega në Kaçanik aktualisht ka të angazhuar 4 gjyqtar duke përfshirë edhe mbikëqyrësin e degës. Një gjyqtar i cili ka qenë në trajnim fillestare për gjyqtar në Akademinë e Drejtësisë e i cili ka qenë i caktuar për këtë degë, është avancuar në Gjykatën Komerciale në Prishtinë, gjë që do të ndikoj në planifikimin e arrijes së objektivave të kësaj dege.

Ndërsa në Gjykatën Themelore në Ferizaj – dega në Shtërpcë janë të angazhuar mbikëqyrësi i degës, një gjyqtar në lëmine penale dhe kundërvajtëse si dhe një gjyqtar në lëmine civile. Gjyqtari që aktualisht është i caktuar në lëmine civile në muajin gusht arrin moshën e pensionimit dhe pozita e tij duhet të plotësohet me ndonjë gjyqtar tjetër.

Gjykata Themelore në Ferizaj-Dega në Kaçanik

Të dhënat për lëndët e trashëguara, të pranuara, në punë, të kryera dhe lëndët e pa kryera për tremujorin e dytë të vitit 2023 (1 prill deri më 30 qershor 2023) për Gjykatën Themelore në Ferizaj-Dega në Kaçanik.

Lloji i lëndëve	Lëndët të trashëguara	Lëndë të pranuara-2023	Gjithësejt lëndë në punë	Lëndë të kryera	Gjithësejt lëndë të pa kryera
Procedura Paraprake - DP	103	19	122	15	107
Penale shkalla e parë- DP	837	58	895	87	808
Procedurë Paraprake - DKR	0	0	0	0	0
Penale shkalla e parë - DKR	0	0	0	0	0
Penale për të mitur në proc.përgaditore	0	0	0	0	0
Penale për të mitur në proc.Para Kolegjit	0	0	0	0	0
Civile të shkallës së I-rë	1365	82	1447	110	1337
Jashtëkontestimore	313	10	323	24	299
Përmbarimore	959	112	1071	42	1029
Përmbarime sipas dokumenteve autentike	625	0	625	0	625
Përmbarime sipas dokumentit përmbarues	47	0	47	0	47
Ekz.Pausballa dhe shpenzime gjyqësore	819	86	905	71	834
Ekz.civile PPP	137	7	144	11	133
Ekz.Penale me burg	32	8	40	7	33
Ekz. Penale me gjobë- EDGJ	183	30	213	39	174
Ekz.i masave edukative për të mitur	0	0	0	0	0
UGJK	0	0	0	0	0
GJITHËSEJT	5420	412	5832	406	5426
Lëndët tjera: certifikata, v.apostile, etj	0	0	0	0	0
Lëmia Kundërvajtëse	Lëndët të trashëguara	Lëndë të pranuara-2023	Gjithësejt lëndë në punë	Lëndë të kryera	Gjithësejt lëndë të pa kryera
Lëmia- Kundërvajtëse	978	149	1127	220	907
GJITHËSEJT	978	149	1127	220	907

Gjkata Themelore në Ferizaj-Dega në Shtërpçë

Të dhënat për lëndët e trashëguara, të pranuara, në punë, të kryera dhe lëndët e pa kryera për tremujorin e dytë të vitit 2023 (1 prill deri më 30 qershor 2023) për Gjykatën Themelore në Ferizaj-Dega në Shtërpçë.

Lloji i lëndëve	Lëndët të trashëgura	Lëndë të pranuara-2023	Gjithësejt lëndë në punë	Lëndë të kryera	Gjithësejt lëndë të pa kryera
Procedura Paraprake - DP	48	5	53	5	48
Penale shkalla e parë- DP	185	20	205	41	164
Procedurë Paraprake - DKR	0	0	0	0	0
Penale shkalla e parë - DKR	0	0	0	0	0
Penale për të mitur në proc.përgaditore	0	0	0	0	0
Penale për të mitur në proc.Para Kolegjit	0	0	0	0	0
Civile të shkallës së I-rë	444	37	481	48	433
Jashtë kontestimore	28	4	32	3	29
Përbartimore	243	21	264	27	237
Përbartime sipas dokumenteve autentike	0	0	0	0	0
Përbartime sipas dokumentit përbartues	17	0	17	0	17
Ekz.Paushtalia dhe shpenzime gjyqësore	132	10	142	28	114
Ekz.civile PPP	21	1	22	2	20
Ekz.Penale me burg	2	0	2	0	2
Ekz. Penale me gjobë- EDGJ	8	1	9	0	0
Ekzi masave edukative për të mitur	0	0	0	0	0
UGJK	0	0	0	0	0
GJITHËSEJT	1128	99	1227	154	1073
Lëndët tjera: certifikata, v.apostile, etj	0	0	0	0	0
Lëmia Kundërvajtëse	Lëndët të trashëgura	Lëndë të pranuara-2023	Gjithësejt lëndë në punë	Lëndë të kryera	Gjithësejt lëndë të pa kryera
Lëmia- Kundërvajtëse	147	25	172	35	137
GJITHËSEJT	147	25	172	35	137

Nga gjyqtarët vazhdimisht është kërkuar respektimi i planeve strategjike siç është Plani Strategjik Për Përmirësimin e Qasjes në Drejtësi 2022-2025 dhe Plasni Strategjik për Zgjidhjen Efikase të Lëndëve të Korrupsionit dhe Krimit të organizuar, ashtu që lëndët të trajtohen sipas prioriteteve dhe udhëzimeve që dalin nga këto plane, njëkohësisht që mos lejojnë shtyrje të panevojshme të seancave.

Në përfundim konsiderojmë se kjo periudhë e tremujorit të dytë është me efikase në raport me periudhën e parë tremujore të këtij viti, kemi një rritje të efikasitetit në përqindje nga 78,04% në 96% te efikasitetit në total në të gjitha lëmitë. Po ashtu në këtë tremujor vërehet në zvogëlim i trendit të ardhjes së lëndëve të natyrës civile në krahasim me periudhën paraprake dhe kemi një rritje të dukshme te përqindjes së efikasitetit në divizionin civil nga 45.56% që ishte në periudhën

e parë të këtij viti, në 72.15%, e që është nëse vazhdohet me këtë trend do të shkojmë në përmirësim të gjendjes në këtë divizion i cili ka qenë sfidë në këto dy-tre vitet e kaluara. Megjithahtë ky divizon ende mbetet sfidë për Gjykatën Themelore në Ferizaj, dhe për këto arsyesh takime me gjyqtar të divisionit civil është kërkuar që të angazhohen me tepër në trajtimin e lëndëve në këtë divizion duke u angazhuar edhe ndihma e bashkëpunëtoreve profesional. Po ashtu është kërkuar që trajtimi i këtyre lëndëve të bëhet përmes procedurave alternative siç është ajo e ndërmjetësimit edhe pse është tentuar vazhdimisht referimi i këtyre rasteve në ndërmjetësimit, mirëpo palët nuk kanë shpreh gatishmëri për një gjë të tillë.

Megjithatë qasja jonë është që edhe në këto kushte edhe kapacitete që kemi me gjyqtarët aktual por edhe stafi mbështetës administrativ, pavarësisht ngarkesës që kemi, duhet të bëjmë më shumë dhe të jenë më kërkues në drejtim të përshpejtimit apo shkurtimit të kohëzgjatjes së proceseve gjyqësor, duke u fokusuar në vendime cilësore, rritjen të performancës dhe rrjedhimisht arritjes së rezultateve më të larta në punë.

Mustaf TAHIRI

Kryetar i Gjykatës Themelore në Ferizaj

